



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**NJËSIA E AUDITIT TË BRËNDSHËM**

---

**Mbi Auditimin e Brendshëm**

**Ushtruar në Shtëpia e Foshnjës 0-3 vjeç, Bashkia Shkoder**

Njesia e Auditimit Brendshem – Bashkia Shkoder bazuar ne ligjin 114/2015 “Per Auditimin e Brendshem ne sektorin publik”, VKM nr 212 date 30.03.2012 “Per miratimin e kriterëve per ngritjen e Njesive te Auditimit te Brendshem ne sektorin publik”, zhvilloi nje mision auditimi te plote ne Shtëpia e Foshnjës 0-3 vjeç – Bashkia Shkodër, per periudhen 01.01.2015 – 31.12.2016 nga auditimi rezultoi:

**Permbledhje ekzekutive**

Shtëpia e Foshnjës Shkodër funksionon si institucion i përkujdesit shoqëror per sistemimin e fëmijëve të braktisur nga prindërit si dhe fëmijëve që në familjet e tyre kanë problem social- ekonomike. Shërbimi funksionon në përputhje me legjislacionin Shqiptar të shërbimeve rezidenciale,standartet e shërbimit social, ligjit te biresimit,kodit te familjes dhe konventes së të drejtave të femijeve.

Sherbimi rezidencial ka kapacitet maksimal per 35 femije, aktualishte jane 12 femije nga mosha 0 – 3 vjeç , 2 femije te ardhur emergjent me vendim nga zyra e shërbimit social prane Bashkise Shkoder, si dhe prane qendres ditore nuk ka asnje femije.

Shtëpia e Foshnjës 0-3 vjeç, funksionon, bazuar në një rregullore te miratuar vite me parë, bazuar ne ligjin e shfuqizuar per “Përkujdesjen shoqërore,” ka mangesi në organizimin dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm, ne shperndarjen e punës, ne kryerjen e pagesave si paga, prokurime publike, ka mangesi ne percaktimin e objektiveve, dhe ne perpilimin e regjistrimit te riskut. Nuk ka nje sistem qe vlereson performancen e pergjithshme te organizates dhe nuk ka plan te detajuar per kualifikimin e vijueshem te personelit, nuk ka vleresim vjetor pune. Ka mangesi ne percaktimin e rregullores menaxhimit te asetëve.

**GJETJET DHE REKOMANDIMET**

**1.Gjetje** Referuar ligjit nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, perkatesisht nenet 8-12, Shtëpia e Foshnjës 0-3 vjeç ,duhej te ishin

përcaktuar qarte objektivat, perpilimi dhe miratimi i rregullores së brendshme, funksionimi i kontrollit të brendshëm, perlimi i regjistrit të rrisht, duhej të ishte ngritur grupi i menaxhimit strategjik.

**Rekomandime** Përshtatjen e rregullores së brendshme në përputhje me ligjin nr. 10296 date 08.07. “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”, si dhe standartet e përkuqdesjes shoqerore, detajimin në menyre analitike të të gjithë aktivitetëve që kryen cdo punonjes, detajimin e sistemit të kontrollit sipas aktivitetëve, miratimin e rregullores nga Kryetari i Bashkisë. (bashkelidhim modelin e rregullores).

Përcaktimin e objektiveve të institucionit, vleresimin e mundësive së ndodhjes së ngjarjeve, si dhe përparimin e regjistrit të rrisht.

**2.Gjetje** Referuar pikës 13 të udhezimit 30 “Për menaxhimin e aktiveve në Njesinë e Sektorit Publik” nëpunësi i autorizuar me lirim nga detyra duhej të kishte bërë dorëzimin e aktiveve që ka pasur në dorëzim në momentin e largimit, si dhe nga nëpunësi i autorizuar i emëruar në atë periudhë duhej të ishte ngritur një komision për marrjen në dorëzim të gjithë aktiveve. Ish/nëpunësja e autorizuar është larguar pa bërë dorëzimin e aktiveve që ka pasur në dorëzim, si dhe nëpunësja e emëruar në atë periudhë nuk ka ngritur komisionin për marrjen në dorëzim të aktiveve.

**3.Gjetje** Referuar nënëve 9, 23,24, të ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”, duhej të ishte kryer informimi i organeve eprorë si dhe duhej të ishte ngritur sistemi i monitorimit, ndërsa nëpunësi i autorizuar nuk ka informuar me shkrim të pakten në fund të vitit ushtrimor lidhur me funksionimin e kontrollit të brendshëm.

**Rekomandim** Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të informimit dhe monitorimit, si dhe kryerjen e dokumentimit, për të bërë të mundur evidentimin në kohë të problematikave me qëllim për mirësimin e efikasitetit të institucionit.

**4.Gjetje** Referuar nënit 64 të ligjit 135/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, duhej të ishte paraqitur lista për emërimet me kohë të pjeshme për miratim nga Kryetari i Bashkisë, ndërkohë që kontratat janë firmosur vetëm nga Drejtoresha e Institucionit.

Zgjidhja e kontratës nuk është bërë në zbatim të Kodit të Punës .

**Rekomandim** Emërimet dhe largimet, Stuktura e institucionit, si dhe lista për punonjësit me kohë të pjesëshme duhet të miratohet nga Kryetari i Bashkisë.

**5. Gjetje** Referuar V.k.M nr. 511 date 24.10.2002 ndryshuar V.K.M nr. 463 date 16.06.2011 “Për kohezgjatjen e punës e pushimit në institucionet shtetërore” me kërkese të eprorit të drejtperdrejte dhe me miratim të titullarit të institucionit Qendror,

punonjesit te administrates publike mund ti kërkohej te kryeje ore shtese. Orët shtese kompensohen me pushim, vetëm ne rastet kur është e pamundur dhenie e pushimit për orët shtese, nenpunësi ose punonjësi i administratës ka te drejte te kompensohet me shtese mbi pagën normale. Kompensimi i oreve shtese te duhej te ishte bërë me pushim por është bërë me shtete mbi pagën normale, duke mos bërë planifikim i punës sipas nevojave dhe kapaciteteve.

**Rekomandim** Të behet vleresimi i kohës së punës sipas nevojave dhe kapaciteteve strukturore të punonjësve, për punonjësit që punojnë në turne te dyta e treta, apo jashtë kohës normale të punës të kompensohen me ditë pushimi, ose ne mungese te behet miratimi nga ministria e linjes.

**6. Gjetje** Eshtë vepruar në kundërshtim me pikat a,b,c, pika e 8 e V.K.M nr .717 date 23.6.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetes në institucionet buxhetore dhe nën-punësve të disa institucioneve buxhetore” i ndryshuar.

**Rekomandime** Të ndërpritet menjëherë dhënia e vështërsisë deri në plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e vështirësisë.

Te komunikohet ne rrugë zyrtare me Ministrine e Punës e Çështjeve Sociale për te sqaruar përfitimin e vështërsisë për dëm te shëndetit ne punë, bazuar në të dhënat e raportit auditimit dhe me pas të procedohet me kryerjen e ndalesave per përfitimet në kundërshtim me dispozitat ligjore të mësipërme.

**7.Gjetje** Referuar pikave 3,4,7 neni 2 , neni 40 te VKM nr 914 date 29.12.2014”Rregullat e prokurimit Publik”, Drejtuesi i institucionit duhet te sqaroje arsyen e kryerjes se shpenzimit, bashkangjitur specifikimet e mallit ose te shërbimit,si dhe faturat duhet te nenshkruhen nga te gjithë anetarët e komisionit,si dhe referuar nenet 140-142 Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.02 datë 06.02.2012”Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” , ‘kerkesa per prokurim’ behet nga drejtuesi funksional I institucionit dhe i drejtohet nepunesit autorizues per dijeni nepunesit zbatues,por ne te gjitha blerjet me vlere te nen 100.000 te realizuara nga institucioni, mungojn “kerkesa per prokurim”,specifikimet teknike,faturat e nenshkruar nga komisioni.

**8.Gjetje** Ka mangesi të theksuara ne organizimin, ndjekjen dhe dokumentimin e procedurave të prokurimeve publike, personeli i institucionit nuk është i kualifikuar për kryerje e procedurave publike, janë kryer veprime që bien në kundërshtim me dispozitat ligjore të prokurimeve publike, referuar neneve dhe ligjeve te lartepërmendur.

**Rekomandim** Kualifikimin e personelit per kryerjen e procedurave te prokurimeve publike , duke kerkuar ndihme dhe asistencë nga njësia e Prokurimit Bashkia Shkodër.

**9.Gjetje** Mungon gjurma e auditit veprim qe bie ndesh me udhezimin nr. 57 date 12.06.2014 “Per Gjurmët e auditit ne prokurimet publike”.

**Rekomandim** Të përpilohet gjurma e auditit për tenderat në përputhje me ligjet në fuqi.

**10.Gjetje** Nuk është përpiluar nje regjister i rrishtit lidhur me menaxhimin e aseteve. Nuk është përpiluar dhe miratuar rregullore për menaxhimin e aseteve duke vepruar në kundërshtim me pikat 5-9 te udhezimit nr. 30, janë perfshire inventare me vlere me të vogel se 10.000 lek dhe me afat perdorimi me pak se një vit, duke vepruar ne kundërshtim me piken 29 te udhezimit nr. 30.

**Rekomandim** Të bëhet kualifikimi i personelit lidhur me menaxhimin e aseteve.

Te kerkohet me shkrim prane Bashkisë Shkodër per te vene ne dispozicion rregulloren e aseteve, miratuar nga Kryetare e Bashkise.